REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

# VENDIM

Nr. 688, datë 3.9.2020

## PËR

## NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.199, DATË 4.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E DOKUMENTEVE STANDARDE TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT, TË KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË OFERTËS FITUESE, KUSHTEVE TË MARRËVESHJES KUADËR DHE TË KONTRATËS PËR PROCESIN E RINDËRTIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 42, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Teksti i dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit për punët, shërbimet dhe mallrat, kritereve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për rindërtimin, që i bashkëlidhet vendimit nr.199, datë 4.3.2020, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Agjencia e Prokurimit Publik, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, publikon dokumentet standarde të tenderit, sipas këtij vendimi.

3. Ngarkohen njësitë zbatuese të caktuara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ